



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazne

Nr. -1-04

Data 21.01.2020

Br.

Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt.27.01.2020, ( e hënë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

## R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i kërkesës së DSHMS-së
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Kuvendit komunal për vitin 2019
5. Shqyrtimi i Planit vjetor të punës së Kuvendit komunal për vitin 2020
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit

*Burim Gërguri*  
Burim Gërguri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. 1-03  
Br.

Data 21-01-2020  
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilic - Municipality Assembly Obilic

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.24.12.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Prezent:** Burim Gërguri, Florije Jashari, Fatmir Bekteshi, Qendresa Dubova, Linda Sadiku, Hysni Mjeku dhe Slavisa Spasic

**Të pranishmit tjerë:** Lendita Bekteshi Memisi, drejtoreshë e ad.së përgj. Ilire Kelmendi Shema, drejtoreshë e DKRS-së, Bejtullah Mjekiqi, drejtor për bujqësi dhe zhvillim rural, e Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, Myrvete Paloji, kordinatore për riintegrim për persona të riatdhesuar, Ali Nimani, zyrtar për kulturë dhe përf.i IZHL-së

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesuesi cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Shqyrtimi i Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022
4. Formimi i Komisionit komunal për hartimin e Planit të punës të Kuvendit për vitin 2020
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së, për themelimin e Ansamblit komunal të Qytetit të Obiliqit
6. Shqyrtimi i kërkesës së DBZHR-së, për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore në Mazgit, për ndërtimin e një çerdheje publike me fonde të BE-së
7. Shqyrtimi i kërkesës së DKA-së, për themelimin e Komisionit për intervistimin e kandidatëve për drejtor të shkollës së gjimnazit "17 Shkurti"
8. Shqyrtimi i Draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive "Adem Jashari" objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq
9. Shqyrtimi i kërkesës së DEFZH-së, për Propozim vendimin për tatimin në pronë për vitin 2020
10. Shqyrtimi i kërkesave
11. Të ndryshme

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u aprovua njëzërit nga të pranishmit,

#### **1. Pika parë e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

#### **2. Pika dytë e rendit të ditës**

Aprovohet njëzërit ekstrakti e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

#### **3. Pika tretë e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Për një sqarim më detal rreth Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022, fjalën ia dha kordinatores për riintegrim për persona të riatdhesuar.

**Myrvete Paloji** – Sa i përket Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar ne kemi filluar sipas procedurave sepse ne si ZKKK, bashkëpunojmë me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ne sikur të gjitha Komunat, është dashur ta mbajmë një trajnim dhe e kemi përgatitë Draft Strategjinë për vitin 2019-2020. Debati publik është mbajtur sipas Rregullores nr.13/2017, në bazë të së cilës ne punojmë. Kjo është një Strategji si bazë mbështetjeje, që secili institucion ose Drejtori e ka një Rregullore se si duhet të punohet.

**Kryesuesi** - Këtu, nuk kemi të bëjmë me Strategji, por bëhet fjalë për Planin komunal për riintegrim të qëndrueshëm për personat e riatdhesuar 2019-2022. Unë i kam 2 pyetje për të cilat ju duhet të përgatiteni për mbledhjen e Kuvendit, a kemi plan për vitin 2018-2019, nëse pyet dikush se sa kanë qenë persona të riatdhesuar. Pyetja tjetër është se në planin e juaj 2019-2022, cili është parashikimi juaj optimal, maksimal dhe minimal se cilët janë personat që mund të kthehen. Poashtu, a jemi të përgatitur ne për një fluks të madh për numrin e mundshëm të njerëzve nëse, do të kthehen.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2019-2022.**

**Pika e 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Ju e dini se për vitin 2019, ka qenë i aprovuar Plani i punës i Kuvendit komunal dhe deri në këtë fazë ne jemi në mbledhjen e 15, prej tyre 12 mbledhje janë të rregullta, 2 të jashtëzakonshme dhe 1 mbledhje solemne. Tani, ideja është të formohet një grup prej Kuvendit dhe Ekzekutivit, të cilët do të punojnë rreth planit të punës të Kuvendit komunal për vitin 2020.

**Fatmir Bektashi** – Propozon që Komisioni për hartimin e Planit të punës të Kuvendit, të përbëhet prej 3 anëtarëve.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal formimin e Komisionit komunal për hartimin e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2020.**

**Pika e 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti kërkesën nga DKRS-ja, për formimin e Ansambllit komunal të Qytetit të Obiliqit.

**Hysni Mjeku** – Ne derisa marrim rekomandim, është dashur ta kemi Projekt Statutin dhe Projekt Rregulloren, në mënyrë që ti dijmë aktivitetet e zhvillimit të Ansambllit, të cilin do ta themelojmë.

**Kryesuesi** – Sqaron se paragrafi i fundit i kërkesës e ka shpjegue shumë mirë sepse ne po e themelojmë njëherë Ansambllin, pastaj vijnë aktet tjera normative.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht i rekomanduan Kuvendit shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së DKRS-së, për themelimin e Ansambllit komunal të Qytetit të Obiliqit.**

**Pika e 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqet kërkesën nga DBZHR-ja, për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore në Mazgit, për ndërtimin e një çerdheje publike me fonde të BE-së.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DBZHR-së, për shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore në Mazgit, për ndërtimin e një çerdheje publike me fonde të BE-së.**

**Pika e 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqet kërkesën nga DKA-ja, për themelimin e Komisionit për intervistimin e kandidatëve për drejtor të shkollës së gjimnazit “17 Shkurti”.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht i rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin e kërkesës së DKA-së, për themelimin e Komisionit për intervistimin e kandidatëve për drejtor të shkollës së gjimnazit “17 Shkurti” (dhe plotësim me anëtarin e tretë nga MASHT-i).**

**Pika e 8 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Ju e dini se përpara e kemi pasë Rregulloren për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive “Adem Jashari” ndërsa tash e kemi shtue edhe paragrafin e fundit objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq.

**Ali Namani** – Ju njoftoj se në këtë Draft Rregullore, gjithsejt janë inkorporuar 6 nene dhe ky dokument ka dalë në diskutim publik, por vërejtje nuk ka pasë.

**Kryesuesi** – Pyeti sa do të jetë një orë për shfrytëzim të palestrës sportive.

**Ali Nimani** – Përgjegjet se kjo çështje është e rregulluar me Rregullore pas konsultimit me Zyren ligjore dhe shefin e financave dhe nuk është e nevojshme që tarifat të shkruhen në këtë Rregullore sepse aty janë tarifat specifike.

**Kryesuesi** – Propozon që në faqen nr.6, të Draft Rregullores në fjalë, të gjitha çmimet që janë nga Rregullorja për tarifa dhe ngarkesa të përfshihen. Në faqen nr.6, mund ta shtoni edhe një nen.

**Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimsht i rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive “Adem Jashari” objekteve sportive dhe fushave të hapura publike në Obiliq (pas neniot 11 të shtohet një nen me çmime për shfrytëzim faqe 6.)**

**Pika e 9 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqë kërkesën nga DEFZH-ja, për Propozim vendimin për tatimin në pronë për vitin 2020.

**Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimsht i rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DEFZH-ja, për Propozim vendimin për tatimin në pronë për vitin 2020.**

**Pika e 10 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Paraqiti kërkesat të cilat u rekomanduan për mbledhjen e Kuvendit komunal.

- a) Kërkesa nr.I-38250, e dt.18.11.2019 i rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim.
- b) Kërkesa nr.I-38277, e dt.18.11.2019, i rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim.
- c) Kërkesa nr.V-38397, e dt.13.11.2019, i rekomandohet DPUKP-së për shqyrtim
- d) Kërkesa nr.I-38558, e dt.21.11.2019, i jepet Kryetarit të Komunës për shqyrtim.

**Pika e 11 e rendit të ditës**

**Kryesuesi** – Pasi që nuk kemi asgjë të diskutojmë në këtë pikë të rendit të ditës, e përfundoj mbledhjen.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:57**

**Procesmbajtëse**

  
**Azize Zeneli**

